



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 24 shkurt 2021, në mbledhjen e dytë (2) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Isak Ejupi, Komandant i Stacionit të Policisë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj.Albina Avdiu, kryesuese e Komitetit për Komunitete; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa munguan: z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; Armend Bikliqi, përfaqësues i FSK-së; z.Driton Velu, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës theksoi, përshëndetje për të gjithëve, mirë se keni ardhë në mbledhjen e dytë të KKS-së. Materialet për mbledhje konsideroj i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28 janar 2021

2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- **Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë**
- **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Isak Ejupi.

z.Isak Ejupi Komandant i Stacionit të Policisë, sa i përket situatës së sigurisë në Komunën e Podujevës gjendja është e qetë dhe stabile, nuk kemi ndonjë informacion apo indikacion që periudha vijuese mund të ketë ndonjë çrregullim në përmasa të rendit dhe sigurisë publike, ndërkohë ne po vazhdojmë me aktivitetet tona operative në përpjekje për të konsoliduar gjendjen e sigurisë por edhe në mirëmbajtjen në ato kategori të cilat qëndrojnë mirë. Shqetësues janë veprat penale kundër jetës dhe trupit që realisht lënë pasojë edhe në komunitet, si dhe aksidentet e trafiku ku ka një rritje të numrit të tyre, ndërkohë që kemi një rritje progresive në disa kategori siç janë veprat penale kundër lëndëve të narkotikëve. Kemi identifikuar posedues të lëndëve të

narkotikëve dhe këto raste i kemi trajtuar, ndërkohë më gëzon fakti që kemi një rënie solide të rasteve të veprave penale kundër pronës që ka qenë synim i imi pas detektimit të një gjendje jo të mirë në këtë fushë dhe jam shumë i lumtur që me disa plane operative që i kemi realizuar kemi arrit që t'i arrestojmë tetë (8) persona të cilët kanë kryer vepra penale të vjedhjeve të rënda. Gjendja e sigurisë vazhdon të jetë relativisht e qetë në këtë fushë edhe pse ne do të vazhdojmë aktivitetet tona për parandalim identifikim dhe arrestim të kryerësve të veprave penale. Aktivitetet që i kemi filluar në këtë javë vlen me përmend ligjërimin në shkolla sa i përket përdorimit të narkotikëve.

Përfaqësuesi i FSK-së, Rreshteri Armend Bikliqi theksoi, sa i përket sigurisë në Komunë e Podujevës konsiderojmë se është e qetë dhe stabile, ndërsa sa i përket aktiviteteve, FSK nga mbledhja e fundit që është mbajtur deri më tani, nuk ka pasur, por çfarëdo që të kërkohet nga Komuna ne jemi të gatshëm që të veprojmë.

Përfaqësuesi i KFOR-it, Togeri Kovatcs, theksoi, sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës nga ana e KFOR-it, vlerësohet e qetë dhe stabile. Edhe më tutje misioni i KFOR-it do të jetë që të sigurojë qetësinë dhe sigurinë në tërë rajonin e Kosovës.

z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës theksoi, nëse keni diçka për të shtuar urdhëroni, nëse jo atëherë kalojmë në pikën e radhës.

3.Informatë lidhur me gjendjen e Pandemisë - Covid 19 në Komunën e Podujevës

- Shëndetësia

- Arsimi

z.Driton Veliu drejtor i DSHMS theksoi, sa i përket situatës epidemiologjike në Komunën e Podujevës në javën e fundit kemi një vlerësim shumë të mirë në raport me muajt nëntor, dhjetor dhe janar. Duke filluar prej paraqitjes së rastit të parë në muajin mars 2020 deri më sot në Komunën e Podujevës kemi 3001 raste pozitive me covid 19, prej tyre 2773 raste të shëruar, 184 raste aktive dhe për fat të keq 44 raste të vdekjes. Gjatë këtyre muajve në QKMF, në Qendrën anti covid kemi pasur 7824 vizita mjekësore të dyshimta për covid 19, ku prej këtyre vizitave janë konfirmuar 3001 raste pozitive. Në muajt e fundit, duke filluar nga muaji korrik me rritjen e numrit të madh të rasteve, ne kemi bërë një kërkesë në IKSHPK dhe duke i'u falënderuar bashkëpunimit të Komunës së Podujevës me Ministrinë e Shëndetësisë jemi Komuna e vetme që nuk jemi qendër rajonale, që ofrojmë shërbime të nivelit parësor shëndetësor, por që na është lejuar për marrjen e mostrave për qytetarët e dyshuar me virusin Covid 19. Mbi 5000 mostra janë marrë në QKMF në Podujevë dhe janë dërguar në IKSHPK, mirëpo varësisht prej rritjes së rasteve kemi edhe raportet, ka raste kur numri i mostrave rritet në nivel nacional ku rezultatet mund të variojnë prej 48 h deri në tri ose katër ditë. Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor kemi pasur numër të madh të pacientëve të infektuar me virusin covid 19, ku marrja e rezultateve ka zgjatur deri në tri ose katër ditë mirëpo tani numri i pacientëve të infektuar me covid 19 ka rënë dhe rezultatet merren brenda 48h. Për të gjithë mërgimtarët të cilët vijnë në Kosovë dhe i'u duhet rezultati i testit për covid 19, RT-PCR rezultatit mund ta marrin brenda 24h, marrja e mostrave bëhet në QKMF në Podujevë prej orës 8:00-10:00, të mëngjesit, ndërsa rezultatet merren në IKSHPK, ky është një mirëkuptim që kemi hasur te IKSHPK-ja dhe është ekskluzivisht për mërgimtarët, ndërsa për banorët rezident marrja e rezultateve zgjatë deri në 48h. Meqenëse situata epidemiologjike në nivel nacional është më e mirë edhe koha e pritjes së rezultatit për testin RT-PCR është zvogëluar padyshim në këtë kanë ndikuar edhe disa institucione tjera që janë licencuar për marrjen e testit RT-PCR dhe atë të antitropave. Situata epidemiologjike për momentin është më e mirë dhe më e menaxhuar dhe ne kemi vazhdimisht bashkëpunim me IKSHPK-në, Policinë, DKA-në, DI, të cilët i falënderojmë shumë për bashkëpunimin që kemi si institucione.

z.Avni Fetahu, procesi mësimor në kushte pandemie në Komunën e Podujevës është duke u zhvilluar sipas tre skenarëve apo modaliteteve të rekomanduara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Sipas skenarit A mësimet zhvillohen në shkollë me orar dhe përmbajtje të reduktuar por që mësimin e vijnë direkt në shkolla dhe organizohet po thuajse në të gjitha shkollat fillore

dhe të mesme të ulëta në Komunën e Podujevës me përjashtim të shkollës SHFMU “Naim Frashëri” në Podujevë, shkolla këto që për klasat e shtata (7), teta (8) dhe klasat e nënta (9), zhvillojnë mësimin sipas skenarit B ku mësimi zhvillohet me rotacion në shkollë dhe në distancë. Sipas skenarit B mësimi zhvillohet edhe në tri shkollat e mesme në Komunën e Podujevës ku njëri grup e zhvillon në shkollë kurse grupi tjetër nga distanca me rotacion një javë njëri grup, kurse grupi tjetër javën vijuese. Furnizimi i shkollave me material higjienik dhe materiale tjera anti covid 19, është bërë nga DKA në bashkëpunim me donatorë të huaj. Një veçori e këtij viti është që në koordinim me punëtorët teknik kemi bërë dezinfektimin me qëllim për të ruajtur buxhetin e kontraktuar më herët. Të prekur me virusin covid 19 në shkollat e Komunës së Podujevës janë tre (3) mësimdhënës, prej tyre një mësimdhënës në SHFMU “Ibrahim Rugova”, një në SHFMU “Xheladin Rekaliu” dhe një në SHFMU “Ali Hadri”, në fshatin Obrançë, si dhe një punëtor teknik në shkollën “Eqrem Çabej”, në fshatin Buricë, ndërsa nxënës të infektuar me virusin covid 19 kemi gjithsej nëntë (9). Si informatë e përgjithshme, prej 316 mësimdhënësve të testuar deri më tani 120 kanë rezultuar pozitiv me covid 19, kurse prej 410 nxënësve të testuar, 107 kanë rezultuar pozitiv me covid 19.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, falënderojmë drejtorët për informatat e paraqitura, nëse dikush nga ju ka diçka për të shtuar urdhëroni.

z.Isak Ejupi, dua të ju njoftojë se ne i kemi identifikuar disa probleme në shkolla dhe planifikojmë t’i ndërmarrim disa veprime që kanë të bëjnë me rritjen e nivelit të sigurisë në shkolla. Në të kaluarën kur kam qenë komandant këtu, kemi ndërmarrë veprime të ngjashme dhe fatkeqësisht kemi hasur nxënës që kanë poseduar edhe armë zjarri, mirëpo të gjitha ato kategori të pajisjeve që janë të rrezikshme për jetën dhe trupin e njeriut duhet të parandalohen. Kemi identifikuar prezencë të theksuar të personave në oborret e shkollave në orët e vona të natës, ndërkohë në këto shkolla mungon ndriçimi dhe është kërkesë e jona që në bazë të mundësive buxhetore nëse është e mundur të bëhet ndriçimi publik i atyre shkollave në mënyrë që ne të kemi më të lehtë punën për identifikimin e këtyre personave. Gjatë natës ka ndodhë një vjedhje në shkollën e fshatit Obrançë ku fatkeqësisht në këtë shkollë po përsëriten vjedhjet. Unë kam kërkuar nga shefi i hetimeve që të ngritet një grup hetimor dhe veçanërisht aktet e tilla ndaj shkollave të hetohen dhe eventualisht të bashkëpunojmë me drejtoritë e shkollave dhe DKA-në, në mënyrë që të arrijmë rezultate në këtë fushë.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetari i Komunës falënderojmë komandantin për këtë informatë dhe mendoj se veprimet e ndërmarra janë të mirëseardhura e veçanërisht për sigurinë në shkolla. Besoj se në këtë aspekt me drejtorin e DKA-së do të keni bashkëpunim të ngushtë, është mirë që ato të bëhen por gjithsesi me staf policor pa uniformë, atëherë kur ju e vlerësoni se është momenti i duhur, është fjala për tri shkollat e mesme të qytetit por duke mos përjashtuar edhe shkollat Fillore të Mesme të Ulëta sepse edhe në këto shkolla ka pasur raste të tilla. Drejtori i DKA-së po ashtu do ta merr si detyrë që të koordinohet me drejtorin e DSHPMSh që shtyllat e ndriçimit solar që janë duke u zhvendosur prej Sheshit të qytetit të vendosen nëpër pozicione të përshtatshme në oborret e shkollave sepse ka shtylla të mjaftueshme të ndriçimit publik dhe të njëjtat të shfrytëzohen dhe të zgjidhet ky problem. Pra meqenëse infrastruktura ekziston, atëherë të funksionalizohet ndriçimi në këto shkolla.

z.Avni Fetahu, sa i përket informatës në shkolla, parashihi edhe pikat që me të drejtë i ceku Komandanti i Policisë, ku njëra ndër to është edhe ndriçimi dhe rrethojat por edhe instalimi i kamerave të sigurisë, por për fat të mirë kemi nda mjete buxhetore për planifikim për çështjen e sigurisë. Shkolla “Ali Hadri”, në fshatin Obrançë nuk ka kamera të sigurisë dhe jam njoftuar se rastet e cekura janë përsëritur kohë pas kohe, për fatin e mirë në ato shkolla ku janë instaluar kamerat e sigurisë është stabilizuar gjendja e sigurisë. Lidhur me bashkëpunimin e policisë kam adresuar një kërkesë te drejtorët e shkollave sepse kam marrë vërejtje prej Stacionit Policor në Podujevë që shpeshherë kanë shkuar policia dhe nuk kanë pasur vend për t’i vendosur pajisjet e tyre dhe nuk kanë gjetur as nxënësit prezent lidhur me trajnimet e tyre, kështu që kam kërkuar prej të gjithë drejtorëve të shkollave që kur të vijë policia për të trajtuar një temë të caktuar

atëherë të trajtohet në mënyrën më të dinjitetshme të mundur, mirëpo ne e kemi këtë si informatë të përgjithshme që përfshihet në muajt e ardhshëm.

znj.Albina Avdiu, meqenëse jemi duke e diskutuar çështjen e arsimit kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, lidhur me dy qendrat për mësim nxënie që funksionojnë në kuadër të OJQ VORAE në Komunën e Podujevës, të cilat prej shfaqjes së pandemisë nuk janë funksionale andaj ju pyes lidhur me takimin që keni pasur para ca dite me organizatën në fjalë a keni arritur ndonjë marrëveshje apo keni marrë ndonjë përgjigje se kur pritet të rihapen këto qendra.

z.Avni Fetahu, ka mbetur obligim i organizatës në fjalë që të sjellë një aneks kontratë ku specifikohet qartë çështja e mjeteve financiare për shkak që këtë vit edhe për kundër një marrëveshje që është lidhë nga qeverisja e kaluar nuk kanë lënë mjete buxhetore. Vullneti i Kryetarit ka qenë i madh për të shtyrë këtë proces tutje kështu që ka mbet nga ana e tyre të na sjellin një aneks kontratë dhe në koordinim me DBF-në, me arrit këtë marrëveshje deri në muajin shtator pastaj me mundësitë buxhetore që do ti ketë Komuna për vitet në vijim Kryetari është zotuar për të vazhduar në këtë proces.

z.Liman Zeqiri, e dëgjova me vëmendje Komandantin e Stacionit të Policisë dhe më inkurajoi të flas diçka për çështjen e lëndëve narkotike. Duke e ditur situatën në të cilën gjendemi e përgëzoj Komandantin dhe DKA-në, për të gjitha masat që janë duke u ndërmarrë për vetëdijesimin e nxënësve sidomos të atyre në moshën e adoleshencës sepse kjo është një çështje jashtëzakonisht e rëndë ose do e quaj një sëmundje e rëndë në tërë rajonin. Në bazë të informacioneve që i kemi ne si Komunë, e kemi edhe obligim qytetarë që t,i vetëdijesojmë të gjithë përdoruesit e këtyre lëndëve, që ta ruajmë shëndetin publik, e në veçanti fëmijët tanë sepse është e ndjeshme kjo dukuri negative. Kryetar, ju merreni me proceset mësimore sepse jeni ligjërues dhe profesor dhe jeni i vetëdijshëm se ne duhet ti ruajmë dhe të përkujdesemi për nxënësit tanë sepse kjo problematikë ka marrë përmasa edhe në rajon. Ne e dimë gjendjen edhe në Shqipëri dhe vendet tjera për rreth por megjithatë bazuar në gjendjen në nivel vendi Komuna jonë qëndron më mirë lidhur me dukurinë në fjalë, andaj e përgëzoj drejtorin e DKA-së për ligjëratat lidhur me vetëdijesimin e nxënësve sidomos në shkollat e mesme, andaj ne duhet të kemi një kontroll më të madh që kjo dukuri mos të rritet edhe në vendin tonë sepse pasojat mund të jenë shumë të mëdha. Ne duhet të jemi parandaluesit e kësaj dukurie negative prandaj jemi pjesë e këtij këshilli për të kontribuar dhe për të ndihmuar, sugjeruar dhe vetëdijësuar fëmijët tanë rreth këtyre dukurive negative. Unë e përgëzoj Policinë, DKA-në dhe të gjitha organet tjera që merren me këtë çështje për parandalimin e kësaj dukurie që është shumë shqetësuese për ne.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, ne si institucione jemi të gatshëm që t'i marrim të gjitha përgjegjësitë që të vazhdohet me këto trajnime dhe ligjërata të ndryshme rreth kësaj dukurie negative dhe besoj që Komandanti i Policisë ka personel kompetent që merren me këtë fushë dhe janë njohës të mirë të kësaj fushe, andaj ato trajnime apo ligjërata janë shumë të mirëseardhura për nxënësit dhe fëmijët tanë. Këtu besoj se nuk do të ketë ndonjë ngecje dhe do të vazhdojmë me punë dhe aktivitete për luftimin e kësaj dukurie negative.

4. Miratimi i propozimit të planit të punës të KKS-së për vitin 2021

Informatë për aktivitetet e KKS-së në vitin 2020

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka kryesuesi i grupit punues për përgatitjen e materialeve z. Avni Fetahu.

z.Avni Fetahu, sa i përket propozim të Planit të punës së KKS-së për vitin 2021, në dokument ku janë përfshirë një sërë aktivitete. Nuk do të thotë se kemi arritur të përfshijmë të gjitha aktivitetet që mund të paraqiten gjatë vitit 2021. Ky material është udhërrëfyes i punës së këtij Këshilli, pra janë disa nga aktivitetet bazë, janë të përfshirë aktet përgjegjëse për kryerjen e këtyre aktiviteteve, institucionet dhe afatet kohore kur duhet të kryhen. Pra propozimi i Planit përfshinë pikat më kryesore.

Drejtori në vazhdim foli për pikat tematike të planifikuara dhe rëndësinë e tyre dhe përshkoi në detaje të gjitha punët dhe aktivitetet e KKSB-së të planifikuara sipas propozimit të Planit të punës së KKSB-së për vitin 2021.

Pra mund të propozohen edhe tema tjera të veçanta që ju i vlerësoni si të nevojshme dhe me rëndësi për sigurinë publike.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, theksoi, kam një sugjerim lidhur me pikën e 15 të propozim planit, te tema : *Informatë për dukuritë negative dhe masat senzibilizuese kundër dukurive negative, përdorim i narkotikëve vjedhje dhe dhunë*, e paraparë për muajt qershor-shtator, të parashihet për muajin tetor nëse ju e vlerësoni ose në muajt mars – tetor, ndërsa *Informata për ambientin* në pikën 16 sugjeroj të parashihet në muajin mars,pra kam këto dy sugjerime nëse edhe ju pajtoheni.

z.Isak Ejupi, theksoi, pajtoj propozimin e parë të dhënë nga Kryetari, kurse për propozimin e dytë besoj që muaji maj është më i përshtatshëm për shumë arsye. Muaji mars mund të jetë kohë e pa përshtatshme për shkak të kushteve klimatike ndërsa në muajin maj fillon shkëputja nga stina e dimrit dhe fillimi i stinës së pranverës dhe është muaj më i përshtatshëm por si do qoftë ju vendosni. Muaji maj është muaj kur ne aktivitetet policore i rrisim rreth liqenit për shkak të gjuajtjes së peshqve në mënyrë ilegale dhe është periudhë që ndalohet gjuajtja e peshqve.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, theksoi, nëse nuk ka ndonjë sugjerim atëherë po e vejmë në votim këtë pikë të rendit të ditës me ndryshimin:

Konstatim:

Propozimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2021 aprovet nga KKSB dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me ndryshimin (propozim i Kryetarit të Komunës z. Shpejtim Bulliqi) që informata në pikën 15, e paraparë në muajt qershor-shtator të parashihet për muajt mars-tetor.

z. Avni Fetahu, sa i përket Informatës së KKSB-së për vitin 2020, dokumenti përmban të dhënat më kryesore të punëve dhe aktiviteteve të Këshillit për periudhën e cekur, të dhëna që janë nxjerrë nga procesverbalet e mbledhjeve të KKSB-së të vitit të kaluar ku ne nuk kemi qenë pjesë e ekzekutivit, andaj informatat i kanë secili prej tyre kështu që nuk është e nevojshme për të shtuar diçka.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës theksoi, lidhur me informatën në fjalë nëse dikush ka diçka për të shtuar apo heq urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës

Konstatim:

Informata për punët dhe aktivitete e KKSB-së për vitin 2020 u kalua pa vërejtje dhe e njëjta procedohet në Kuvendin e komunës.

5. Të ndryshme

z.Isak Ejupi, kam një kërkesë për vendosjen e dy-tri pengesave në rrugën afër xhamisë së qytetit sepse është mjaft e ngarkuar, sidomos pasi që është mbyllur qendra dhe njëkohësisht në këtë rrugë ka vozitje të rrezikshme. Ne si stacion i policisë po aplikojmë pika kontrolli të shumta në atë segment mirëpo do të ishte mirë të vendosen dy apo tri pengesa në mënyrë që të ndikoj në uljen e shpejtësisë dhe rritjen e sigurisë në këtë segment të kësaj rruge.

z.Liman Zeqiri, sa i përket këshillit të KKSB-së dhe rëndësisë që ka dua t'ju njoftoj se anëtarët e KKSB-së çdo herë janë paguar me një pagesë simbolike. Në bazë të takimeve që kam pas me komunat tjera jam njoftuar se çdo komunë i paguan anëtarët e KKSB-së dhe mund të jetë si temë edhe nga ekzekutivi i kaluar andaj unë sugjeroj që të vazhdohet pagesa si më parë, apo mëditje ta quaj. Për gjashtë (6) mbledhje brenda viti është mirë që mëditjet për anëtarët që vijnë si përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike prej Orllani të kompensohen sepse këtu bëhet

fjalë për sigurinë tonë për fëmijët tanë. Mund të ketë implikime buxhetore andaj dua që të sqarohet kjo çështje.

z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, unë nuk e di se si është vepruar më parë dhe sigurisht se unë nuk do të veproj ndryshe sepse nuk jam ithtar të bëjë dallime, mirëpo për ata anëtarë të KKSB-së që janë në orar të punës ky takim llogaritet si pjesë e punës mirëpo ka edhe anëtarë tjerë që nuk janë shërbyes civil dhe në orar të punës, si do që të jetë nga Zyra ligjore mund të na jepen sqarime lidhur me pagesat në fjalë. Sa i përket këtij problemi nga ana ime është gjithçka në rregull vetëm të mos bëhen shkelje të procedurave ligjore, vetëm shikojeni dhe analizojeni mirë bazën ligjore. Këto takime janë shumë të rëndësishme, andaj të veprohet në këtë drejtim me kujdes dhe në bazë të rregullativës ligjore.

Kryetari përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-060/04-0018703/21

Podujevë, 24 shkurt 2021

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**